



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 642 Prot.

Gjirokastrë, më 02 / 06 / 2022

Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me Universitetin IES Ribeira Do Luoro të Spanjës.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti IES Ribeira Do Luoro i Spanjës ka fituar një grant për kërkim shkencor dhe trajnim në bashkëpunim me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes kërkohet që Universiteti i Gjirokastrës të marrë pjesë me:
2 pozicione për staf akademik të cilët do të angazhohen në mësimdhënie për një periudhë 5 ditore në Universitetin IES Ribeira Do Luoro.

Gjuha e përdorur do të jetë anglisht në nivelin B2 për stafin akademik për mësimdhënie.
Nëse jeni të interesuar, lutemi të dërgoni pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **06.06.2022**:

- një letër interesi, në shqip dhe anglisht.
- një CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS në shqip dhe në anglisht.
- një provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze sipas niveleve të specifikuar më sipër.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet palës së Universitetit IES Ribeira Do Luoro, për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR

